



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI

Nr. 2416 Prot

Tiranë, më 02.06 2022

UDHËZIM

Nr. 355, datë 02.06.22

**“PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMIT TË INTEGRUAR LËVIZËS  
NË FAMILJE, PËR FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE FAMILJET E TYRE  
DHE MANUALI I ZBATIMIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 3 të nenit 27 dhe 51 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**


1. Miratimin e standardeve të shërbimit të integruar lëvizës në familje, për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre dhe manuali i zbatimit, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, apo dhe/ose personave juridik publik/privat, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.
4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

OGERTA MANASTIRLIU





**STANDARDET E SHËRBIMIT TË  
INTEGRUAR LËVIZËS NË  
FAMILJE, PËR FËMIJËT ME  
AFTËSI TË KUFIZUAR DHE  
FAMILJET E TYRE DHE MANUALI  
I ZBATIMIT**

TIRANË 2022



## PËRMBAJTJA E LËNDËS

|   |           |
|---|-----------|
| Standardet e Shërbimit të integruar lëvizës në familje për fëmijët me AK dhe familjet e tyre.....     | 3         |
| 1.1 Informacion i Përgjithshëm.....   | 3         |
| Standardi 1.....  | 9         |
| Standardi 2.....  | 11        |
| Standardi 3.....  | 15        |
| Standardi 4.....  | 20        |
| Standardi 5.....  | 24        |
| Standardi 6.....  | 24        |
| Standardi 7.....  | 27        |
| Standardi 8.....  | 29        |
| Standardi 9.....  | 30        |
| Standardi 10.....   | 33        |
| Standardi 11.....   | 40        |
| Personat me aftësi të kufizuar, grupet përfituese dhe tipologjia e shërbimit.....                     | 43        |
| 1.1 Personat me aftësi të kufizuar.....   | 43        |
| <b>PJESA E PARË: ASPEKTET ORGANIZATIVE TË SHËRBIMIT.....</b>  | <b>44</b> |
| 2.1 Deklarata e qëllimit.....   | 44        |
| Përfituesit.....  | 45        |
| iii. KUSH E OFRON SHËRBIMIN E INTEGRUAR LËVIZËS NË FAMILJE.....                                       | 51        |
| iv. PËRGJEGJËSITË E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE.....  | 64        |
| v. BASHKËPUNIMET.....   | 64        |
| <b>PJESA E DYTË: VLERËSIMI, HARTIMI I PLANIT I KUJDESIT INDIVIDUAL DHE I RAPORTIT TË ECURISË.....</b> | <b>65</b> |
| 2.1 Vlerësimi, hartimi i planit të kujdesit individual dhe i raportit të ecurisë.....                 | 65        |
| 2.3 Formulari për informacionin paraprak.....   | 68        |
| 2.4. Raporti i Vlerësimit të Nevojave dhe Ecurisë për PAK-un (RVNE).....                              | 68        |
| 2.5 Plani i kujdesit individual (PKI).....  | 69        |
| 2.6 Konsultimi, pjesëmarrja dhe përfshirja e fëmijës me aftësi të kufizuar dhe familjes.....          | 70        |
| 2.7 Trajtimi i keqtrajtimit dhe abuzimeve.....  | 70        |
| 2.8 Procedurat e ankimimit.....   | 70        |
| 2.9 Koha e lirë dhe veprimtaritë.....   | 71        |
| Shtojca 1: Formulari për informacionin paraprak.....  | 71        |
| A- Historia personale (Anamneza).....   | 71        |



|  |           |
|--|-----------|
| B- Historia familjare e PAK-ut (klinike).....  | 71        |
| C- Informacioni për probleme sociale të familjes së fëmijës me aftësi të kufizuar .....    | 71        |
| Shtojca 2: Vlerësimi biopsikosocial .....  | 71        |
| <b>Shënim: Ky formular duhet të plotësohet brenda muajit të parë të frekuentimit .....</b> | <b>82</b> |
| KARTELË FIZIOTERAPIE .....   | 82        |
| FLETË VLERËSIMI – PSIKOLOGU .....  | 86        |
| FLETË VLERËSIMI – PUNONJËSI SOCIAL .....   | 91        |
| KARTELË LOGOPEDIKE .....   | 92        |
| Tabela për nivelet e ashpërsisë të Spektrit të Autizmit .....                              | 95        |
| Shtojca 3 Tabela përmbledhëse e analizës së shërbimit.....                                 | 96        |
| Shtojca 4: Plani i kujdesit individual .....   | 99        |
| Shtojca 5: Formulari i ankesës.....  | 101       |

## **Standardet e Shërbimit të integruar lëvizës në familje për fëmijët me AK dhe familjet e tyre**

### **I.1 Informacion i Përgjithshëm**

Hartimi i paketës së standardeve të shërbimeve të integruara lëvizëse në familje për fëmijët me aftësi të kufizuara (AK) dhe familjet e tyre përbën një hap të rëndësishëm për rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror për këtë grup fëmijësh. Standardet plotësojnë detyrimet për zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015-2023 dhe Ligjit nr.121, datë 21.11.2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Këto standarde do të shërbejnë si instrument bazë për sigurimin dhe matjen e cilësisë së shërbimeve dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, Ligjin Antidiskriminim, Ligjin Nr. 9355 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, i ndryshuar, me “Konventën për të Drejtat e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar”, “Konventën për të Drejtat e Fëmijës”, të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, dhe “Konventën e Rehabilitimit Komunitar”, të Organizatës Botërore të Shëndetësisë .

Paketa e Standardeve të Shërbimeve Lëvizëse të specializuara në familje për fëmijët me AK dhe familjet e tyre bazohen mbi parimet e njohura të kujdesit shoqëror, si:

- Parimi i respektimit të të drejtave të fëmijës dhe dinjitetit e integritetit të përfituesit;
- Drejtësisë sociale;
- Partneriteti;
- Subsidiariteti,
- Decentralizimi, ku shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë individit/komunitetit;
- Mosdiskriminimi;
- Integrimi shoqëror;
- Gjithëpërfshirja;
- Liria;
- Siguria;
- Pavarësia.

Hartimi i standardeve të Shërbimeve të integruara lëvizëse në familje për fëmijët me AK dhe familjet e tyre është një ndër objektivat e reformimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ky reformim synon deinstitutionalizimin e shërbimeve, shtimin e shërbimeve për fëmijët me AK dhe rritjen e cilësisë së tyre, për t’iu përgjigjur nevojave të fëmijëve me AK dhe familjeve të tyre për përkujdesje psikosociale, terapi individuale mjekësore në mjedisin e tyre familjar natyral në kohë dhe me cilësi, duke realizuar të drejtën e fëmijës për t’u rritur në një mjedis të shëndetshëm familjar që mundëson zhvillimin e potencialit të tyre të plotë individual.